



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1943 Prot.

Tiranë, më 27.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 92 dt. 27.08. 2025

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT NR.68, DATË 03.06.2025
“PËR MIRATIMIN E STRESS TEST (PROVË USHTRIMORE) PËR PËRBALLIMIN
FIZIKISHT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT, PËR STUDENTËT FITUES NË
KONKURSET E PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË BACHELOR, PËR
VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Kërkesën e Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve nr.1, datë 27.08.2025 për shtyrje të afatit, Vendimin e Rektoratit nr. 89, datë 27.08.2025, në nenin 20 të Statutit të UST- së, nenin 7 të Rregullores së UST, Senati Akademik

VENDOSI

1. Të ndryshohet pika 1 e Vendimit nr.68, datë 03.06.2025 si vijon:

Ishte: Fituesit e konkurseve të pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” dhe në “Fushat e aktivitetit fizik, të shëndetit dhe rekreacionit” për vitin akademik 2025-2026, të paraqesin në fazën e regjistrimit dokumentin e kryerjes jashtë UST të kontrollit “Stress test” (Provë Ushtrimore) për të vijuar studimet në këto programe.

Bëhet: Fituesit e konkurseve të pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” dhe në “Fushat e aktivitetit fizik, të shëndetit dhe rekreacionit” për vitin akademik 2025-2026, të paraqesin në Sekretarinë Mësimore Digjitale dokumentin e kryerjes jashtë UST të kontrollit “*Stress Test*” (Provë Ushtrimore) deri në datën 30.01.2026 (para fillimit të sezonit dimëror të provimeve).

2. Studentët që nuk paraqesin dokumentin e kryerjes së testit sipas pikës 1 të këtij Vendimi, nuk do të mund të vijojnë me provimet e Sezonit të Dimrit të vitit akademik 2025-2026.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA



Prof. Asc. Arben KAÇURRI



Dr. Aisel OSEKU




Prof. Dr. Dhurata BOZO



Prof. Asc. Elton SPAHIU



Prof. Asc. Ferdinand MARA



Prof. Asc. Fisnik BROVINA



Prof. Asc. Klotilda VRENJO




Prof. Dr. Kujtim KAPEDANI



Prof. Asc. Oltiana PETRI



Prof. Dr. Robert ÇINA



Prof. Asc. Robert CITOZI

